



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT ANALIZË VJETORE - 2025

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit gjatë vitit 2025 ka realizuar detyrat për komponentët si vijon:

1. Përafrimi i legjislacionit

Përafrimi i legjislacionit kombëtar me legjislacionin evropian dhe rregulloret evropiane të standardizimit (ETSI, CEN&CENELEC) dhe ndërkombëtare (ISO dhe IEC) është ndër objektivat kryesorë të DPS. Nga auditet e kryera nga vlerësues të pavarur të CEN&CENELEC, si dhe takimet me ekspertë të BE gjatë procesit *screening* rezulton se aktualisht paketa ligjore e standardizimit është në përputhje të plotë me legjislacionin evropian dhe rregulloret evropiane të standardizimit (ETSI, CEN&CENELEC) dhe ndërkombëtare (ISO dhe IEC).

Këtë vit DPS nuk ka patur iniciativa të reja ligjore e nënligjore për fushën e saj të përgjegjësisë.

2. Anëtarësimi me të drejta të plota në CEN&CENELEC

Gjatë vitit 2025, DPS vazhdoi me takime, komunikime dhe raportime mbi përparimin e bërë në përmbushjen e planit të punës të përcaktuar nga vlerësuesit e CEN & CENELEC. Në zbatim të procedurës së shqyrtimit të kërkesave për antarësim në CEN&CENELEC, Komiteti i Marrëdhënieve dhe Monitorimit të Anëtarësimit të CEN&CENELEC (MRMC) në vendimin e marrë në mbledhjen e tij të Shtatorit 2025 gjykon se jo të gjitha detyrat e lëna në Planin e Veprimit të auditit janë plotësuar nga ana e Shqipërisë.

Në këtë vendim, MRMC vlerëson lart punën, angazhimin dhe përparimin e bërë nga DPS në zbatimin e Planit të Veprimit, siç ishte rënë dakord me vlerësuesit homologë, dhe vëren se dokumentacioni i paraqitur ka qenë i plotë. Megjithatë, një kërkesë kyçe që lidhet me Kushtin 9.2 (*“Një kuadër specifik ligjor për standardizimin vullnetar është në fuqi dhe plotësisht funksional”*) — zbatimi i plotë i legjislacionit në fushën e harmonizuar — mbetet i paplotësuar.

Duke iu referuar gjithashtu progress raportit të BE, të Prillit 2025, për anëtarësimin në BE (Kap.1), MRMC vëren se përafrimi i Shqipërisë me kërkesat e BE-së mbetet i pjesshëm në fusha kyçe si vlerësimi i konformitetit, metrologjia, mbikëqyrja e tregut, notifikimet dhe përgjegjësia për produktin.

Për këto arsye, MRMC ka konkluduar se aplikimi i DPS nuk mund të rezultojë me sukses në këtë fazë dhe e fton DPS të ri-aplikojë sapo kuadri ligjor në fushën e harmonizuar (përmendur më lart) të jetë plotësisht i përputhur me atë të BE-së dhe funksional.

3. Proceset e integrit

Lidhur me proceset e integrit – *screening* për Kapitujt 1, 20 dhe 28 të *acquis*, DPS ka prezantuar situatën e standardizimit në vend dhe planet/afatet për aktet ligjore/nënligjore që duhet të përafrojnë, si dhe vazhdimin e punës në zbatim të kriterëve për antarësim me të drejta të plotë në CEN&CENELEC.

Fusha e standardizimit, duke konsideruar edhe legjislacionin aktual, i cili është në përputhje të plotë me *acquis* në këtë fushë, është konsideruar e kënaqëshme, por kërkohet ndjekja e akteve ligjore (rregullore/direktiva) të BE-së në fushën e standardizimit dhe planifikimi i hartimit dhe miratimit të tyre në legjislacionin vendas. Gjithashtu, ndjekja e zbatimit të kriterëve të funksionimit të një organi kombëtar për standardizimin në përputhje me ato evropiane mbetet objektiv kryesor i DPS edhe përtej anëtarësimit të plotë të saj në dy organizmat evropiane të standardizimit CEN&CENELEC, si një parakusht ky për anëtarësimin e vendit në BE.

4. Adoptimi i standardeve evropiane e ndërkombëtare si Standarde Shqiptare

Gjatë vitit 2025 janë adoptuar si Standarde Shqiptare (SSH); 3,398 Standarde Evropiane dhe ndërkombëtare, duke përfshirë amendamentet dhe dokumentet e standardizimit, nga të cilat të ndara sipas origjinës janë:

- 1,955 CEN
- 635 CENELEC
- 570 ETSI
- 63 ISO
- 175 IEC

5. Promovimi dhe publikimet

Për të forcuar kuptimin publik të rolit të standardeve, në Tetor 2025 DPS ishte pjesë e një video promovuese me temë “Digjitalizimi i DPS”. Videoja është publikuar edhe në faqen e internetit të DPS www.dps.gov.al në linkun: [Digitalization of Albanian Standards](#) dhe thekson se si shërbimet e modernizuara të standardizimit mbështesin konkurrueshmërinë e NVM-ve, përmirësojnë qasjen në standardet e harmonizuara evropiane dhe rrisin transparencën për konsumatorët dhe përdorim më të gjerë të standardeve në sektorë të ndryshëm.

Gjithashtu, janë përkthyer/përgatitur dhe publikuar në faqen e web-it dhe në rrjetet sociale të DPS mbi 43 artikuj dhe 115 ekstrakte standardesh të fushave, të cilat janë publikuar në faqen e internetit të DPS dhe në rrjetet e saj sociale. Publikimet kryesisht i përkasin fushave si vijon:

- Transporti
- Kimia
- Siguria e lodrave
- Materiale në kontakt me ushqimin
- Mobilje
- Teknologjia e informacionit
- Pajisje mbrojtëse personale
- Siguria ushqimore
- Produkte nafte, lubrifikantë

- Pajisje elektroshtëpiake
- Sigurimi i cilësisë dhe përgjegjësia sociale
- Kimia
- Mjekësia
- Turizmi dhe shërbimet e ngjashme me të
- Laboratorë mjekësorë
- Produkte ushqimore
- Cilësia e ujit, ajrit dhe tokës
- Artikuj të kujdesit për fëmijë
- Performanca energjetike e ndërtesave
- Shëndeti dhe siguria në punë
- Materiale ndërtimi
- Pajisje mbrojtëse personale
- Makina dhe traktorë
- Sigurimi i cilësisë dhe përgjegjësia sociale
- Stomatologji

Janë publikuar dhe shpërndarë tek palët e interesit katër Buletine dhe shtojca e Buletinit 101/1, përkatësisht Buletini Nr. 101, Nr.102, Buletini Nr.103 dhe Buletini Nr. 104 siç jepet në vijim:

Buletine informative			
Nr	Periudha	Përmbajtja e informacionit	Komente
101	Tetor – Dhjetor 2024	Standardet e adoptuara dhe standardet e shfuqizuara gjatë kësaj periudhe.	Buletini për këtë periudhë publikohet në ditët e para të janarit të vitit në vijim.
101/1	Janar – Dhjetor 2025/Programi i punës për adoptimin e standardeve	Programi i punës i vitit 2025 me draft standardet shqiptare dhe draft dokumentet shqiptare për opinionin publik.	Shtojca e tij publikohet pas mbledhjes së Bordit Teknik për miratimin e Programit të Punës me Standarde.
102	Janar – Mars 2025	Standardet e adoptuara dhe standardet e shfuqizuara gjatë kësaj periudhe.	
103	Pril – Qershor 2025	Standardet e adoptuara dhe standardet e shfuqizuara gjatë kësaj periudhe.	
104	Korrik - Shtator 2025	Standardet e adoptuara dhe standardet e shfuqizuara gjatë kësaj periudhe.	

6. Bordi Drejtues

Bazuar në Ligjin nr.9870/2008 “Për Standardizimin”, të ndryshuar dhe Vendimin nr.433/2010 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e Bordit Drejtues të DPS”, të ndryshuar, Sekretariati i DPS në bashkëpunim me Kryetarin e Bordit Drejtues ka organizuar 2 mbledhje gjatë vitit 2025. Në këto mbledhje Bordi ka ndjekur punën dhe realizimin e objektivave për fushën e standardizimit, ka dhënë orientimet dhe ka mbështetur punën mbi proceset integruese të

DPS në dy Komitetet Evropiane të Standardizimit (CEN&CENELEC), si dhe ka shqyrtuar dhe miratuar programin e punës së DPS për vitin 2025, përbërjen e Bordit Teknik të saj, bashkëpunimin e DPS me institucionet dhe çështje të tjera me rëndësi për standardizimin në vend.

7. Bordi Teknik

Bazuar në Ligjin nr.9870/2008 “Për Standardizimin”, të ndryshuar, Vendimet e Bordit Drejtues dhe Rregulloren e Brendshme të DPS, Sekretariati i Bordit Teknik DPS ka organizuar dy takime të Bordit, ku janë diskutuar mbarëvajtja e Komiteteve Teknike të DPS, përbërja e tyre dhe ndryshimet në to sipas rastit, janë diskutuar dhe miratuar fushat prioritare dhe standardet evropiane e ndërkombëtare për adoptim dhe publikim si Standarde Shqiptare, është miratuar plani vjetor i punës për adoptimet, ndryshimet dhe shfuqizimet e Standardeve Shqiptare, si dhe është kërkuar publikimi i tyre në Buletinën informative të DPS.

8. Trajnime

Gjatë vitit 2025 stafi i DPS ka marrë pjesë në aktivitete dhe evente të organizuara në fushën e standardizimit dhe është trajnuar për çështjet si vijon:

1.	Trajnim i organizuar (<i>online</i>) nga CEN (Komiteti Evropian për Standardizimin) me tematikë “Si përfitojnë konsumatorët nga standardet” ku janë trajtuar dhe përfitimet që marrin kompanitë nga zbatimi i standardeve
2.	Workshop IEC/ISO SMART Conference_organizuar nga ISO (Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit)
3.	Pjesëmarrje në mbledhjen e CEN/TC 164 (Komiteti Teknike për Cilësinë e Ujit i Komitetit Teknik Evropian për Standardizimin (CEN) i cili u zhvillua në Berlin të Gjermanisë.
4.	Trajnim mbi “Ndërgjegjësimi - Përfshirja e konsumatorit në punën e standardeve” organizuar <i>online</i> nga CEN
5.	Trajnim mbi Praktikën e mirë dhe zgjidhjet dixhitale të përdorura në Institutin e Standardizimit të organizuar nga GIZ dhe Instituti i Standardizimit të Serbisë (<i>online</i>)
6.	Trajnim mbi “Standardet dhe Dixhitalizimin” organizuar nga GQSP/UNIDO Albania
7.	Workshop (dy ditor) mbi “Mundësimin gjithëpërfshires përmes integritetit gjinor në Infrastrukturen e Cilësisë për Tregtinë,” organizuar në kuadër të projektit të UNECE në Hotel Tirana International.
8.	ISO Good Standardisation Practices- webinar held by ISO
9.	“Siguria online: çfarë duhet t’u mësojmë fëmijëve dhe të rinjve”, ASPA
10.	“AI në Administratën Publike”, ASPA
11.	"Inteligjenca Artificiale në Menaxhimin e Administratës Publike", ASPA
12.	"Protokolli zyrtar dhe Etiketa e Shtetit", ASPA
13.	"Parimi i konfliktit të interesit dhe integritetit", ASPA
14.	"Lidershipi në administratën publike: Rol strategjik për performancë dhe sukses", ASPA
15.	"E ardhmja e menaxhimit të projekteve: certifikimi, digjitalizimi dhe transformimi", ASPA

16	"Menaxhimi i Kulturës Organizative në Administratën Publike: Nga Strategjia te Sjellja", ASPA
17.	"Inteligjenca emocionale", ASPA
18.	"Fazat e procedurës administrative, fillimi i procedurës dhe hetimi administrativ", ASPA
19.	"Higjiena Kibernetike Dhe Praktikat Më Të Mira Të Sigurisë"- AKSK
20.	"Lidershipi i bazuar në vlera dhe etikë", ASPA
21.	"Plani personal i zhvillimit", ASPA
22.	"Transparenca dhe aksesimi në informacion publik", ASPA
23.	"Procesi i vlerësimit të punës në zbatim të ligjit për shërbimin civil", ASPA
24.	"Sistemi i Prokurimit Elektronik", ASPA
25.	Pezullimi dhe transferimi në shërbimin civil, ASPA
26.	Marrëdhëniet individuale të punës, të drejtat, detyrimet përparësitë e normave juridike
27.	Pjesëmarrje në Takimin e parë zyrtar të Grupit të punës të CEFTA që lidhet me masat jo-rregullatore të Vendimit të Komitetit të Perbashkët dhe Vizite Studimore në CEN/CENELEC / Prezantim me Komitetin Teknik të CEN, CEN/TC 331 "Shërbimet postare"

9. Notifikime - Zbatimi i VKM 789/2009 "Për notifikimet në zbatim të Marrëveshjeve për barrierat Teknike në Tregti dhe të Masave Sanitare dhe Fitosanitare të Organizatës Botërore të Tregtisë"

Për periudhën Janar 2025- Dhjetor 2025 është bërë 1 notifikim në Sekretariatit e OBT dhe në CEFTA, nëpërmjet platformave *eping* dhe *CEFTA Transparency Pack*.

Konkretisht, është notifikuar:

- Projekt Vendimi "Për miratimin e rregullave të hollësishme lidhur me kushtet, masat dhe kontrollet e ngarkesave të produkteve organike ose në kalim të importuara" në datën 24/04/2025. Për këtë notifikim nuk ka pasur komente nga anëtarët e OBT, në përfundim të periudhës së komenteve, është njoftuar me email Ministria që ka dërguar projekt vendimin, në këtë rast Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për vazhdimin më tej me miratimin e projektvendimit.

Janë bërë rregullisht edhe notifikimet përkatëse në CEN dhe CENELEC për të gjitha adoptimet e standardeve europiane si Standarde Shqiptare, nëpërmjet platformës *iProjex*.

10. Shitja e Standardeve Shqiptare (SSH)

Është tejkaluar plani i shitjeve të standardeve në rreth 18% (722 nga 612 që ishte plani) më shumë Standarde Shqiptare të shitura.

Standardet më të shitura janë të fushave: siguria kibernetike, cilësia e ajrit, tokës dhe ujit, përgjegjësi sociale, standardet e karburanteve, etj.

11. Projekti GQSP/UNIDO

Si pjesë e përpjekjeve të DPS-së për digjitalizim, projekti mbështeti DPS me pajisjen e Përkthimit të Asistuar nga Kompjuteri (CAT) për të përmirësuar cilësinë dhe konsistencën e përkthimeve të standardeve. Në Nëntor 2025 DPS i është vënë në

dispozicion një licencë të përhershme me disa përdorues, duke siguruar qëndrueshmëri afatgjatë dhe cilësi përkthimi. CAT është plotësisht funksional dhe mundëson konsistencë të terminologjisë, lehtësi në përkthim dhe përpunim më të shpejtë të teksteve të standardeve, kryesisht të atyreve të harmonizuara evropiane (hEN). Kjo adreson drejtpërdrejt një nga rekomandimet kryesore të CEN/CENELEC dhe forcon efikasitetin operativ të DPS-së si dhe gatishmërinë për integrim të plotë në rrjetin evropian të standardizimit. Po kështu, jo më pak e rëndësishme është vlera e këtyre standardeve të jenë të përkthyer plotësisht në shqip për përdoruesit vendas. Pajisja e DPS me këtë licencë është shoqëruar nga licencuesi i CAT edhe më disa trajnime për stafin e DPS, të organizuara gjatë muajit Dhjetor 2025.

12. Auditim i brendshëm

Gjatë muajit Shtator-Tetor 2025 DPS u auditua nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për periudhën Janar 2024 – Korrik 2025.

Objekti i auditimit: Sistemi i menaxhimit buxhetor; Krijimi dhe përdorimi i të ardhurave dytësore; Pagat dhe menaxhimi i burimeve njerëzore; prokurimet e fondeve publike; komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit; kontabiliteti dhe raportimet financiare.

Në plotësim të objektit të auditimit stafi i DPS vuri në dispozicion të audituesve legjislationin, rregulloret e brendshme, procedurat e punës së DPS dhe bëri shpjegimet e nevojshme për çfarë iu kërkua nga grupi i auditimit. Në përfundim, u lanë rekomandime në përmirësim të performancës së menaxhimit buxhetor, përmirësimin e kapaciteteve administrative të DPS, si dhe ndërmarrjen e fushatave ndërgjegjëse për rëndësinë e pjesëmarrjes në punën kombëtare të standardizimit. Rekomandimet do të reflektohen në programet vjetore dhe ecurinë e përditëshme të punës së DPS.